**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
DHOMA E NOTERISE DURRES
NOTERIA KAVAJE
Rep. 2038
Kol. 1073

**N O T E R**
**ARBER I. ALIU**
Lagja nr.4, Rruga "Indrit Cara", ne Kavaje,
Cel: 0693320020
e-mail: arber_aliu@yahoo.it

# *KONTRATE SHITBLERJE*

*"Kuota Sh.p.k - je"*

Ne Kavaje, sot, me date **31/Tetorë/ 2018** (dymije e tetembedhjete), diten e Merkure para meje noterit publik **ARBER I. ALIU**, anetarë i Dhomes Noterise Durres, paisur me license **nr.500,** rregjistruar ne QKB me nipt **nr.L32605802K**, u paraqiten personalisht shtetasit kerkues per redaktimin e kesaj kontrate me keto cilesi ligjore dhe Identitete:

**PALE SHITESE** **NADIR ISMAILI**, i biri i Nazim dhe Bakushe, lindur me date 03/04/1977 ne Kavaje, Durres, banues ne Kavajë, Lagjen nr.5, rruga "Dituria", identifikuar me leternjoftim **ID.031201861** dhe nr.personal **H70403112B**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**PALE BLERESE** **RUZHDI VOGLI**, i biri i Selim dhe Nexhate, lindur me date 09/03/1957 ne Kavaje, Durres, banues ne Kavajë, Lagjen nr.3, identifikuar me leternjoftim **ID.028215365** dhe nr.personal **F70309138T**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**BAZAT JURIDIKE TE KONTRATES**

NENET: 6,149,705-708,710,711,714,719-723,730 te KODIT CIVIL

Pas njohjes me permbajtjen e dispozitave juridike civile te mesiperme, me vullnetin e tyre te lire te plote, te sinqerte dhe mirekuptim te ndersjellte mes tyre, palet lidhin kete kontrate, sipas ketyre deklarimeve:

- Une pala shitese, **NADIR ISMAILI**, me statusin ligjor te bashke ortakut te shoqerise **"PORTA KAVALJA" sh.p.k**, rregjistruar si person juridik ne **QKB**, duke u paisur me çertifikaten nipt **nr.L82519804G**, e cila sipas ekstratit te **QKB** eshte me status aktiv.
- Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000,00 leke, i formuar dhe nenshkruar nga ne bashke ortaket themelues, **NADIR ISMAILI** dhe **RUZHDI VOGLI**, me nje kontribut ne shumen 50.000,00 Leke, e barabarte me 1-kuote sh.p.k-je, me vlere nominative 50.000,00 lek/l kuote qe zene 50% te Kapitalit Themeltar.
- Bazuar ne te drejten e disponimit qe parashikon neni 149 i Kodit Civil dhe ne Statutin e Shoqerise me Vendimin nr.1, te dates 31/10/2018 te Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te shoqerise, une ortaku **NADIR ISMAILI**, pjesen time takuese te shoqerise **"PORTA KAVALJA"** sh.p.k, me vlere nominative 50.000,00 lek/l kuote, ne shumen 50.000,00 Lek, qe ze 50% te Kapitalit Themeltar ne shoqeri, ia shes ortakut tjeter te shoqerise **"PORTA KAVALJA"** sh.p.k, shtetasit **RUZHDI VOGLI**, me te njenjten vlere nominale kuotash, duke mu bere pagesa ne banke nga ana e tij per te gjithe vleren e ketyre kuotave.

Nadir Ismaili  Ruzhdi Vogli

- Nga pala blerese **RUZHDI VOGLI**, deklarohet se eshte plotesisht dakord, qe te blej 50 % te kuotave te Shpk, te kapitalit themeltar te shoqerise **"PORTA KAVALJA"** sh.p.k, ne pronesi te bashke ortakut **NADIR ISMAILI**, ne shumen 50.000,00 leke, e barabarte me 1 kuota Shpk, me vlere nominative 1 kuote/50.000,00 lek, qe zene 50 % te Kapitali themeltar te shoqerise **"PORTA KAVALJA"** sh.p.k, dhe se te gjithe shumen monetare, ne vleren 50.000,00 leke ja kam parapaguar ne banke, jashte kesaj zyre, pales shitese **NADIR ISMAILI**, fakt qe konfirmohet me deklarim pohues para meje noterit dhe nga vete pala shitese.

- Me nenshkrimin e kontrates, pala shitese **NADIR ISMAILI,** humbet plotesisht **PRONESIN** e kontributit ne formimin e Kapitalit Themeltar ne shumen 50.000,00 Lek, qe zene 50 % te kapitalit themeltar si dhe realizimin e çdo te drejte perfitimi apo mbartje detyrimi per aktivitetin e kesaj shoqerie deri sot me date 31/10/2018 dhe se nga ky afat kohor e per te ardhmen statusin **"Ortake themelues"** te Shoqerise **"PORTA KAVALJA"** Shpk, e fiton pala blerese, **RUZHDI VOGLI.**

Kontrata, me kerkesen e paleve, u redaktua ne 4 ekzemplare, ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njenjta juridike dhe pasi lexohet me ze te larte e te qarte, nenshkruhet nga palet duke vene emrin mbiemrin dhe firmen origjinale.

Une Noteri legalizoj redaktimin korekt dhe vertetoj autenticitetin e nenshkrimeve me cilesin qe me nje e vene emrin dhe mbiemrin origjinal forme nenshkrimi kjo e percaktuar nga neni 46/1 i Ligjit Nr.7829 dt.01.06.1994 "Per Noterin".

**PALE SHITESE**
Ortaku Themelues i Shoqerise
**"PORTA KAVALJA"** Shpk.

Nadir Ismaili

**PALE BLERESE**
Ortaku Themelues i Shoqerise
**"PORTA KAVALJA"** Shpk.

Ruzhdi Vogli

**N O T E R**

Ardor Alia